

# MIKROEKONOMIA

## NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SHKENCËN EKONOMIKE

Alban Asllani, MSc, (PhD cand.)

### Metodat e vlerësimit

Kollokviumi i parë:	45%
Kollokviumi i dytë:	45%
Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime:	10%

Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Duhet të vijnë me kohë në mësim, të mbajnë qetësinë dhe të angazhohen aktivisht gjatë diskutimeve në ligjërata.

## Cilat janë deget kryesore të Ekonomiksit?

Shkenca ekonomike ndahet në dy nensfera të gjera të cilat janë ngushte të nderlidhura në mënyrë të ngushtë, mirpo secila nga to i adreson çështjet e ndryshme ekonomike:

### 1.) MIKROEKONOMIA

### 2.) MAKROEKONOMIA

## Çka studion Mikroekonomia?

4

- **Mikroekonomia** mirret me studimin se si familjet dhe kompanitë marrin vendime dhe si bashkeveprojnë në tregje.
- Mikroekonomia, ka për objekt studimi treguesit ekonomik në nivel të subjekteve ekonomike (kompanive), treguesit e brendshëm të një kompanie si:
  - të hyrat e ndërmarrjes,
  - kalkulimi i kostove të prodhimit të një produkti
  - investimet në pajisje të reja
  - cka duhet prodhuar; çfare produkti?
  - sa duhet prodhuar?
  - përcaktimi i çmimeve të një produkti
  - analiza e tregut dhe konkurrencës në treg
  - analiza e ofertës dhe kërkesës për një produkt/shërbim
  - Elasticiteti i kërkesës dhe ofertës
  - punësimi i punëtorëve dhe organizimi i brendshëm etj.

# Çka studion Makroekonomia?

5

- **MAKROEKONOMIA** – mirret me studimin e dukurive ekonomike ni nivelin e pergjithshem duke perfshire inflacionin, papunesine dhe rritjen ekonomike.
- Makroekonomia, studion funksionimin e ekonomisë kombëtare në përgjithësi, duke analizuar treguesit globalë makroekonomikë në nivel te nje shteti, siç janë:
  - bruto produkti vendor (GDP),
  - Investimet ne ekonomie
  - Politika monetare dhe Sistemi bankar
  - Politika fiskale(tatimet)
  - kursimi,
  - eksporti,
  - importi,
  - punësimi dhe papunësia,
  - inflacioni etj.

## Një vështrim i përgjithshëm mbi shkencën ekonomike

- **Kuptimi i ekonomiksit**
- **Kufiri i mundësive të prodhimit dhe kostoja oportune**
- **Pamje e përgjithshme e ekonomisë së tregut**
- **Përse është e nevojshme njohja e Ekonomiksit**
- **Metodologjia e shkencës ekonomike**

## Kuptimi i ekonomiksit

- Ekonomiksi studjon anen ekonomike te jetes shoqerore, sjelljen e agjenteve ekonomik ne nje shoqeri, dhe kushtet ekonomike te bashkeveprimit te tyre.
- Agjentet ekonomik (vendimmarresit) jane:
  - Individid (familjet) – jane zoterues burimesh dhe konsumatore
  - firmat – eshte secila organizate e cila prodhon mallra ose ofron sherbime
  - Shteti – krijon rregullat e lojes ekonomike dhe mund te krijon mallra dhe ofroj sherbime, si dhe kohe pas kohe mund te nderhyje ne nje ekonomi per te miren e agjenteve ekonomik.

## Kuptimi i ekonomiksit

- Ekonomiksi - studjon se si shoqeria administron burimet e saj te pakta.
  - Me fjale tjera - Si te administrohet ne menyre me eficiente me rezurset e limituara per te sjellur dobite maksimale.
- Ekonomiksi pra studjon procesin ekonomik te nje ekonomie, e cila eshte nderlidhja mes agjenteve ekonomik lidhur me burimet (rezurset), me prodhimin e mallrave dhe sherbimeve, kembimin, shperndarjen dhe konsumin e produkteve/mallrave per te sjellur dobi.

**Ekonomistët besojnë se të gjitha shoqëritë përfshijnë përdorimin e inputeve për prodhimin e outputeve të mallrave / shërbimeve, që plotësojnë kërkesat e një individi (për dobi apo kënaqësinë e tyre)**

**Inputet > Prodhimi > Outputet e Mallrave / Shërbimet > Konsumi > Dobi**

**Burimet/Faktoret e prodhimit janë të limituar**

- Toka
- Puna
- Kapitali


**Ekonomistët besojnë që dobitë apo kënaqësia e një individi është e palimituar**

**Prandaj, problemi socio-ekonomik është: Ekzistojnë dëshira të pafundshme, por resurset për të kënaqur këto dëshira janë të limituara**

## Kuptimi i ekonomiksit

- **Koncepte të rëndësishme në Ekonomiks:**
  - **Pasuri** – pasuria e një vendi përbehet nga stoku i tij i mallrave dhe shërbimeve.
  - **Mireqenja** – I referohet kënaqësisë që një individ ose shoqëri mund të nxjerrin nga konsumi i pasurisë.
  - **Efienca** – ka të bëjë me nxjerrjen e një dobie ose kënaqësie maksimale të mundshme nga përdorimi i burimeve ekonomike.
  - **Drejtësia** – ka të bëjë me shpërndarjen e drejte të mallrave dhe shërbimeve midis grupeve të ndryshme shoqërore dhe individeve.
- Këto koncepte janë të ndërlidhura mes vete dhe mund të paraqiten në një grafikë.

## Kuptimi i ekonomiksit



**Kjo lidhje karakterizohet me një kontraditë mes nevojave të pakufizuara dhe në anën tjetër kufizimet ose rrallesitë apo pamjaftueshmëri të burimeve për plotësimin e këtyre nevojave.**

## Burimet ose Faktoret e Prodhimit

- Burimet mund të quhen edhe si faktoret e prodhimit apo resurset natyrore të cilat e mundësojnë procesin ekonomik.
- Faktoret e prodhimit kryesorë janë:
  1. **Toka** – pasuritë natyrore (toka bujqësore, truall ndërtimi, burimet e energjisë, mineralet, i gjithë mjedisi fizik të na rrethon)
  2. **Puna** – aftësia mendore dhe fizike të njerëzve për të punuar dhe koha në dispozicion për punë
  3. **Kapitali** – me këto kuptojmë vetëm kapitalin fizik dhe jo financiar, të tilla si: pajisjet, makineritë, ndërtesat, inventari, lenda e parë.

Dhe...

  4. **Aftësia Sipermarre** – talenti që kanë disa njerëz për organizimin e burimeve të tjera ekonomike si Puna, Toka, Kapitali për prodhimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve – si dhe kërkimin e mundësive të reja për biznes – dhe zhvillimin e metodave të reja për prodhim.

## Burimet ose Faktoret e Prodhimit

- Faktoret e prodhimit lidhen ne procesin e prodhimit sipas parimeve te caktuara teknologjike
- Teknologjia i referohet aftesise dhe njohurise shkencore ne lidhje me perdorimin e inpueteve ose burimeve natyrore ne procesin ekonomik te prodhimit.
- Nje teknologji e avancuar mund te rrite produktivitetin – qe dmth rrite sasine e prodhimit per njesi te nje inputi.

## Ligji i rrallesise dhe problemi ekonomik

- Faktoret e prodhimit jane te kufizuar per te plotesuar nevojat e pakufizuara.
  - Pra burimet jane te rralla ose te pamjaftueshme. Rrallesia, Pamjaftueshmeria.
- Ligji i rrallesise shpall se mallrat dhe sherbimet jane te rralla, te pamjaftueshem, sepse te pamjaftueshem jane edhe burimet per prodhimin e tyre sipas nevojave te njerezve per konsum.
- Ketu lind domosdoshmeria e Zgjedhjes mes mallrave dhe sherbimeve qe duhen prodhuar.

## Ligji i rrallesise dhe problemi ekonomik

- Pershkak te kesaj rrallesie, pamjaftueshmerie kemi problemin ekonomik kryesore, ose problemin socio-ekonomik ne te gjitha shoqerite te cilat bejne pyetje se si te prodhet per nje mireqenje maksimale.
- **Pyetja është: Si mund shoqëria të përdorë inpuete / resurset e veta në mënyrën më të mirë të mundshme – ne menyre me efikase?**
  - Në këtë pikëpamje kryesore ekonomike, çdo shoqëri ka për të zgjedhur:
    - Çfare te prodhohet?
    - Si te prodhohet?
    - Sa te prodhohet?
    - Per ke te prodhohet?


## Kufiri i mundesive te prodhimit & kostoja oportune

- Problemi ekonomik me se miri mund te spjegohet me anen e kufirit te mundesive te prodhimit
- **Kufiri i mundesive te prodhimit shpreh kombinime te ndryshme te mallrave dhe sherbimeve qe mund te prodhoje nje vend gjate nje periudhe kohore, duke l perdorur te gjitha burimet ne dispozicion dhe teknikat me eficiente te prodhimit.**
- *Shembull: Nje shtet prodhon vetem dy mallra: Ushqime dhe Veshmbathje*

## Kufiri i mundesive te prodhimit & kostoja oportune

Mundesite Alternative te Prodhitimit		
Mundesite	Veshmbathje (per milione njerez)	Ushqime (mije tone)
A	0	15
B	1	14.7
C	2	14
D	3	12
E	4	9
F	5	0
etj		

Kurba e mundësive të prodhimit.



Pika A deri E – përdorim maksimal të kapaciteteve prodhuese  
 Pika M – burimet nuk përdoren plotësisht ose në mënyrë efikase  
 Pika N – kombinim i paarritur

## Kufiri i mundesive te prodhimit & kostoja oportune

- Kufiri i mundesive të prodhimit mund të ndryshojë dhe të zhvendoset në të majtë ose djathtë.
  - Kur laborja zhvendoset majtas kemi një ngushtim apo zvogëlim të mundësive prodhuese. P.sh. Korra të kqija për shkak të thatësirës.
  - Kur laborja zhvendoset djathtas kemi një rritje ekonomike si rezultat i përmirësimeve në teknologji që mund të rrisin produktivitetin, di dhe rritjet e burimeve ekonomike – tokës, popullsisë kapitalit dhe aftësive sipërmarrëse.

## Kufiri i mundesive te prodhimit & kostoja oportune

- Kufiri i mundesive po na tregon që ne duhet të heqim dorë nga një prodhim për të prodhur më shumë nga një prodhim tjetër.
- Kostoja oportune pra paraqet heqjen dorë të sasive të prodhimit të një malli për të rritur sasinë e prodhimit të mallit tjetër.
- Kostoja oportune rrjedh nga rrallesia, pamjaftueshmëria e burimeve ekonomike dhe nevojat e domosdoshme që ne të bëjmë zgjedhje.
- Perderisa dëshirat dhe nevojat tona tejkalojnë burimet, atëherë secila zgjedhje, aktivitet ose veprim ynë shoqërohet nga një kosto oportune.

## Problemi ekonomik në sisteme ekonomike

- Sistemet ekonomike dallojnë mes vete në atë se si ato mundohen të zgjedhin problemin ekonomik.
- Ekonomia e komanduar, e hapur dhe ekonomia e perzier janë tre sisteme ekonomike kryesore.
- Ekonomia e komanduar –
  - nderhyrje të shtetit – alokimi i burimeve ekonomike përcaktohet nga shteti apo qeveria,
  - ku shteti komandon firmat dhe individët që të ndjekin dhe realizojnë planin ekonomik.
  - Shteti përcakton se CKA, SI, SA dhe për KE të prodhohet.
  - Ky sistem është provuar dhe ka rezultuar si jo-eficient në aritjen e mirëqenjes maksimale dhe përdorimin e burimeve ekonomike.


## Problemi ekonomik ne sisteme ekonomike

- Ekonomia e tregut – ndryshe njihet edhe si ekonomia e hapur
  - Pavarësia e agjenteve ekonomik për të vendosur me veprimtarinë e tyre ekonomike, ku prona private është një rëndësi të veçantë.
  - këtu alokohen burimet ekonomike sipas mekanizmit të tregut – ku zgjedhjet behen sipas koordinimit të tregut ose në baze të sinjaleve të tregut
  - Tregu është një vend ku blihen dhe shiten mallrat ose një bashkëveprim mes blerësve dhe shitësve duke përcaktuar çmimin dhe sasinë në treg.
  - Në treg esenciale është paraqja, si mjet këmbimi dhe si masë e vlerës për llogaritjen e çmimit.
  - Çmimi është sinjal kryesor në këtë sistem të ekonomisë ngase bartë informacione tek individët, qeveria dhe firmat se cka, si, sa dhe për kë të prodhohet.
    - Çfare të prodhohet – prodhohen ato mallra të cilat kërkohen më së shumti
    - Si të prodhohet – përdorimi i metodave të cilat minimizojnë kostot dhe përballohet konkurrenca, dhe rritet fitimi
    - Për kë të prodhohet dhe sa të prodhohet – të prodhohet për ata individ të cilët zoterojnë më shumë faktore të prodhimit, sepse nga aty ata përfitojnë të ardhurat e tyre.

## Problemi ekonomik ne sisteme ekonomike

- Ekonomia e perzier –
  - imperfeksione të tregut si papunesia, inflacioni, dhe zhvillimi i strukturave të ndryshme të tregut konkurrues e kanë bërë të nevojshme ndërhyrjen e shtetit në disa raste për të mirën e disa grupeve sociale të cilat kishin veshtirësi për të përballuar jetesën.
  - Në këtë sistem ekonomik qeveria ndërhyne në ekonominë e tregut me tre synime kryesore:
    1. Rritjen e efikasitetit – duke kufizuar format e konkurrencës
    2. Sigurimin e drejtësisë në shpërndarje – ndihma për të varfërit dhe grupeve tjera
    3. Stabilizimin e ekonomisë – duke zbutur luhatjet ciklike të ekonomisë – reduktimi i papunesisë, inflacionit dhe nxitja e rritjes ekonomike.

## Ekonomia e perzier



## Literatura

- Mançellari, Hadëri (2007), "Hyrje në Ekonomi" Pegi Tiranë; Kreu 1, faqe 1-23
- Mankiw & Taylor (2010), "Ekonomiksi" UET-Press UK; Kapitulli 1, faqe 39-114
- Ligjeratat dhe Ushtrimet